

LIGJ
Nr.8420, datë 28.10.1998

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË QËNDRIMIT TË FORCËS GREKE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Zgjatet afati i qëndrimit të forcës greke deri më 25.3.1999.

Neni 2

Statusi dhe përbërja e forcës greke në Shqipëri mbeten po ato që janë miratuar me ligjin nr.8264, datë 18.12.1997.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi me shpalljen e tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2248, datë 3.11.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani